




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Data/Date:	30.12.2024
Nga/Od/From	znj. Blerina Kastrati Idrizi Udhëheqëse e Zyrës për Komunikim me Publikun
Për/Za/To:	z.Bedri Hamza , Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Tema/Subjekat/Subject	Raport i Punës së Zyrës për Komunikim me Publikun Janar – Dhjetor 2024

Zyra për Komunikim me Publikun gjatë periudhës raportuese Janar – dhjetor 2024, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Mitrovicës përmes vegzës zyrtare <https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/> dhe rrjeteve sociale.

Në ueb faqen zyrtare të komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, njoftimet, konkurset, raportet e planet e drejtorive komunale dhe dokumente të tjera në interes të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës.

Zyra për Komunikim me Publikun ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjell njoftimet e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar edhe planet, strategjitë dhe dokumentet tjera të rëndësishme si: plani për konsultime publike, takimet publike, dëgjimet buxhetore, njoftimet, konkurset, dokumentet e prokurimit, dokumentet e kuvendit etj.

Plani i konsultimeve publike është publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/02/PLANI-I-DOKUMENTEVE-PER-KONSULTIME-TAKIME-PUBLIKE-DHE-DEGJIME-BUXHETORE-2024.docx>

Orari i dëgjimeve buxhetore është publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/09/Raport-i-Degjimeve-Buxhetore-per-Buxhetin-e-viteve-2025-2027.pdf>

Njoftimet për takimeve publike janë publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/njoftime-per-konsultime-publike/>

Aktet komunale janë publikuar edhe në platformën e konsultimeve publike në nivel të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Në raportin e MAPL-së për vlerësimin e transparencës në Komuna, Mitrovica ka të përmbushur të gjithë indikatorët e transparencës (<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/05/nRAPORTI..-PER-VLERESIMIN-E-TRANS-11-04-2024-.docx>)

Rezultat i publikimit të dokumenteve në ueb faqen zyrtare të Komunës **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)**, ka vlerësuar Komunën e Mitrovicës me 90.60%.

Instituti GAP, për shkakë të problemeve teknike me ueb faqet e komunave, Komunën e Mitrovicës dhe disa komuna tjera të Republikës së Kosovës nuk i ka përfshirë në vlerësim e saj për transparencë buxhetore.

Me kohë janë publikuar të gjitha njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve të tjera obligative dhe jo obligative. Janë publikuar edhe materialet përcjellëse të cilat janë planifikuar të diskutohen në Komitin për Politikë dhe Financa si dhe në mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Të gjitha vendimet e kryetarit janë publikuar në ueb faqe në kohë reale.

https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/staff/kryetari-i-komunes/#vendimet_main

Njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit publikohen në ueb faqe të Komunës.

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/category/dokumentet-e-kuvendit/>

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 kanë kaluar për Konsultim Publik 9 akte komunale si dhe janë mbajtur 9 takime publike me qytetarë.

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/njoftime-per-konsultime-publike/>

Dy takime publike të kryetarit të komunës me qytetarë

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/takimet-publike/>

Pas mbajtjes së konsultimeve publike, janë përgatitur edhe raportet (me komente) për ecurinë e konsultimit dhe hartimit të dokumenteve të përgatitura nga Komuna.

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/konsultime-publike/procesverbalet-raportet-nga-konsulltimet-publike/>

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur 5 dëgjime buxhetore

<https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/wp-content/uploads/sites/18/2024/07/ORARI-I-vizitave-Degjimet-per-Buxhetin-2025-2027-1.pdf>

1	Komuna Mitrovicë	Plani i Dokumenteve për Konsultime - Takime Publike dhe Degjime Buxhetore per vitin 2024	Tjeter	01.01.2024	31.12.2024
---	------------------	--	--------	------------	------------

2	Komuna Mitrovicë	Projekt - Harta e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031	Tjeter	07.03.2024	07.04.2024
3	Komuna Mitrovicë	Konsultim Publik për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës Nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale	Tjeter	12.03.2024	12.04.2024
4	Komuna Mitrovicë	Tubimi i parë publik i Kryetarit të Komunës për vitin 2024	Tjeter	31.05.2024	13.06.2024
5	Komuna Mitrovicë	Konsultim Publik - Projekt - Plani Komunal për Barazi Gjinore për vitet 2024-2026	Plan i veprimt	10.06.2024	18.06.2024
6	Komuna Mitrovicë	Konsultim Publik - Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027	Tjeter	11.06.2024	20.06.2024
7	Komuna Mitrovicë	Konsultimi Publik për Projekt Buxhetin e Komunës për vitet 2025-2027	Tjeter	02.09.2024	10.09.2024
8	Komuna Mitrovicë	KONSULTIM PUBLIK - DRAFT - STATUTI I BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË MITROVICËS	Tjeter	03.10.2024	11.10.2024
9	Komuna Mitrovicë	Konsultim Publik Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2024 - 2027	Plan i veprimt	16.10.2024	16.11.2024
10	Komuna Mitrovicë	Diskutim Publik Për hartim të Draft-Rregullores për ndryshim- plotësim të Rregullores komunale Nr.01/2022 për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale	Tjeter	01.11.2024	11.11.2024
11	Komuna Mitrovicë	Tubimi i dytë publik i Kryetarit të Komunës për vitin 2024	Tjeter	04.12.2024	18.12.2024

Gjatë vitit 2024, Zyra për Komunikim me Publikun ka bërë publikimin e të gjitha dokumenteve në ueb faqe zyrtare të komunës të parapara me dispozita ligjore.

Komunikata	Konkurse	Njoftime
238	70	250

KOMUNIKATAT 2024

1. Shënohet 25 vjetori i rënies së Heroit Xhevat Jusufi
2. NJOFTIM
3. Shtyhet afati i thirrjes për aplikim për Praktikë në Punë (Internship) për mbështetje për personat e diplomuar të papunësuar deri më datë 12.01.2024.
4. Ftesë -Ju ftojmë në Akademinë Përkujtimore në kujtim të veprimtarit Musa Hoti.
5. DISKUTIM PUBLIK - PËR DRAFT PLANIN E VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026
6. Shpërthimi i bombolës së gazit, fatkeqësisht ka shkaktuar pasoja tek familja Brahimi nga Kçiqi i Mitrovicës ku 14 anëtarë të familjes janë të lënduar.
7. Kryetari i komunës, z. Bedri Hamza, ka njoftuar se komuna e Mitrovicës do të ndajë një shumë prej 20,000 eurosh për të ndihmuar familjen Brahimi, të prekur nga shpërthimi natën e kaluar.
8. U mbajt Akademi Përkujtimore në nder të veprimtarit Musa Hoti
9. Kryetari i komunës, z. Bedri Hamza, gjatë ditës së djeshme ka vizituar minatorët e lënduar nga rrjedha e acidit sulfurik.
10. FTESË - Ju ftojmë në ceremoninë solemne të inaugurimit të objektit të ri të ndërtuar i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Stantërg, e cila do të mbahet me dt. 19.01.2024, duke filluar nga ora 11:00 në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Stantërg.
11. U përurua Qendra e re e Mjekësisë Familjare në Stan Tërg
12. Njoftim nga Drejtoria e Inspektionit për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste dhe Veprimtarive Tjera në Komunën e Mitrovicës
13. Kryetari Hamza nderon dëshmorët Sami Gashi dhe Afrim Hajrizi në ditën e rënies
14. U mbajt mbledhja e 25- të e KPF-së
15. T H Ë R R E T - Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës - Seanca e 27-të
16. Njoftim nga Drejtoria e Inspektionit – Per lirimi e hapësirës publike
17. Kryetari Hamza përcjell nga afër procesin e pastrimit të lumit Lushta
18. Në shkollën fillore "Bedri Gjinaj" lansohet programi "Sporti në Shkollë"
19. U mbajt mbledhja e radhës e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës
20. Drejtoria e Shëndetësisë përmbyll aktivitetet për shënimin e javës së sensibilizimit kundër kancerit të qafës së mitrës
21. U përurua laborator i modern teknik i dhëmbëve në SHML "Xheladin Deda"
22. Gjatë ditës së djeshme, në kuadër të aktiviteteve të DKA-së për ngritjen e cilësisë, u mbajt takim koordinues me Ekipin Komunal për Sigurimin e Cilësisë dhe Ekipin Bërthamë të

ShFMU "Migjeni" i cili vitin e kaluar e ka përfunduar me sukses procesin e vetë-vlerësimit të shkollës.

23. Drejtorja për Shëndetësi ka pranuar donacion një karrige stomatologjike
24. U mbajt punëtorja për zhvillimin e planit për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për zyrën kadastrale komunale
25. Shënimi i Ditës së Internetit të Sigurt në Mitrovicë
26. Teatri "Muharrem Qena" do të shfaqë Premierën e Komedisë “Një Vrasje e vogël Aksidentale”
27. Përkujtohet dëshmori Avni Hajredini në 24 vjetorin e rënies E shtunë, 17 Shkurt 2024, Mitrovica mirëpret Komandantin Legjendar Adem Jashari.
28. T H Ë R R E T - Mbledhjen solemne të Kuvendit të Komunës Seanca e 28-të
29. Me rastin e 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, drejtuesit komunal mirëpritën nxënësit e shkollës “Musa Hoti” të Komunës së Mitrovicës
30. NJOFTIM - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport dëshiron të njoftojë të gjithë qytetarët se në rastin e zhvillimit të Final 8 të Kupës së Kosovës në basketboll.
31. Një delegacion nga Vlora viziton Komunën e Mitrovicës
32. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës mban seancë solemne kushtuar 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës
33. Komuna e Mitrovicës me aktivitete të shumta shënon 16 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës
34. Në Mitrovicë zbulohet shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari
35. Kb Trepça triumfon në finalen e Kupës së Kosovës
36. Kryetari Hamza takon eprorë të lartë të UÇK-së
37. Hapet ekspozita me fotografi nga momentet e shpalljes se Pavarësisë së Republikës së Kosovës
38. Shënohet 35 vjetori i grevës së minatorëve të “Trepçës”
39. T H Ë R R E T - Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa Seanca e 26
40. Telegram ngushëllimi nga kryetari Hamza për familjet Mecinaj e Mangjollli
41. Ambasadori i Shqipërisë, z. Malaj, viziton Mitrovicën
42. Përkujtohen dëshmorët Muhamet Gashi dhe Gazmend Baliu në 25 vjetorin e rënies
43. Njoftim për Shqyrtim Publik – Harta Zonale e Komunës
44. Përrurohet Qendra e Mjekësisë Familjare në Koshtovë
45. Shkolla e Mesme e Lartë Teknike “Arkitekt Sinani” hap panairin e shkollës
46. U mbajt mbledhja e radhës e KPF-së
47. Sportisti i vitit 2023 në Mitrovicë shpallet basketbollisti Drilon Hajrizi
48. Kryetari Hamza priti në takim ambasadorin bullgarë Hristo Gudjev
49. Vendosen tri e-kioska të reja në qytetin e Mitrovicës
50. Komuna e Mitrovicës ndau mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar
51. Njoftim - Me rastin e shënimit të 26-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së) 5
52. T H Ë R R E T - Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës Seanca e 29-të

53. Edhe 6 mjekë te rinj fillojnë punën në QKMF “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë
54. Drejtoria e Bujqësisë shpërndan 121 serra për fermerët mitrovicas
55. Përfaqësuesit komunal nderuan dëshmorët e kombit në 26-vjetorin e Epopesë së UÇK-së
56. Universiteti i Mitrovicës përuroi konviktin dhe menzën për studentë
57. Kryetari Hamza uron të gjithë mësimdhënësit me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit
58. Njoftim - Veprimtarive afariste në Komunën e Mitrovicës së Jugut ju lejohet puna të dielave, deri me datën 12.04.2024.
59. Urimi i kryetarit Hamza me rastin e Ditës së Gruas - 8 Marsi
60. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, z.Bedri Hamza, uron besimtarët musliman për muajin e shenjtë të Ramazanit.
61. Mbahet takim informues për Buxhetimin Gjinnor
62. Komuna e Mitrovicës dhe MZHR nënshkruan marrëveshjen e mirëkuptimit në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal PZHR 2024
63. Nënkryetari Tahiri viziton Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë
64. Mbahet mbledhja e 29- të e Kuvendit Komunal të Mitrovicës
65. Nënshkruhen kontratat e punës edhe me 5 teknik laborant
66. Konsultim Publik për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës Nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale
67. Përkujtohen dëshmorët e kombit Sabedin Prekazi dhe Selim Bislimi
68. U përkujtua masakra e tregut në Mitrovicë
69. Shpërndahen pako ushqimore me rastin e Muajit të Shenjtë të Ramazanit
70. Përrurohen investimet në shkollën “Skenderbeu”
71. Komunikatë lidhur me dëmet në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Mitrovicë
72. Po vazhdojnë punimet te Liqeni Akumulues
73. "Mitrovica, kryeqyteti i Kosovës në Frankofoni 2024"
74. Drejtoria për Shëndetësi, shënon 20 marsin - Ditën e Shëndetit Oral
75. Kryetari Hamza priti në takim Shefin e EULEX -it në Kosovë, Giovanni Pietro Barbano
76. Thirrja e mbledhjes së 27-të të Komitetit për Politikë dhe Financa
77. Njoftim - Lista Preliminare e kandidatëve të përzgjedhur për Regjistruet për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos 2024)
78. Nënshkruhet marrëveshja për investime 1.1 milion euro në rregullimin e infrastrukturës në zonën ekonomike në Frashër
79. Komuna e Mitrovicës pranon donacion 500 pako ushqimore
80. U mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
81. Kryetari Hamza priti në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves
82. Shpërndahen 250 pako ushqimore me rastin e Muajit të Shenjtë të Ramazanit
83. Kryetari Hamza uron qytetarët për Festën e Pashkëve
84. Kryetari Hamza uron KB Trepçën për triumfin në finalen e Ligës Unike
85. Komuna e Mitrovicës përkujton ish-nënkryetarin Riza Haziri në 3 vjetorin e vdekjes së tij
86. Ekspozita e Nxënësve "Unë e Dua Shkollën" shënon Ditën e Fëmijëve në Mitrovicë

87. Ftesë
88. Kryetari Hamza nënshkroi kontratat e bursave për 230 studentë
89. Komuna e Mitrovicës përfiton 53 kontejnera metalik për mbeturina nga Granti i Performancës për Mjedis të Pastër
90. U PËRMBYLL ME SUKSES "JAVA E EDUKIMIT SHËNDETËSOR KUNDËR KONSUMIMIT TË DUHANIT"
91. Shënohet 25 vjetori i Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së në Mitrovicë
92. QPS në Mitrovicë mban ligjërata vetëdijësuese për nxënësit
93. Njoftim për Bletarë
94. Thirrja e mbledhjes së 30-të të KPF-së
95. Rikujtim - Tubimi i parë publik i Kryetarit të Komunës për vitin 2024
96. Konsultim Publik për Planin Komunal për Barazi Gjinore për vitet 2024-2026
97. Shënohet 72 vjetori i Muzeut të Mitrovicës
98. Konsultim Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027
99. U mbajt koncerti i këngëve korale me moton "I këndojmë atdheut në ditën e lirisë"
100. Njoftim për sigurinë e qytetarëve që vizitojnë Parkun e Erës në Bajgorë
101. Kryetari Hamza mbajti takimin e parë publik me qytetarë për vitin 2024
102. U mbajt Panairi i Teknologjisë i shkollave të Mitrovicës
103. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, uron Festën e Kurban Bajramit
104. U mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
105. Legalizo ndërtimin
106. Njoftim nga KQZ
107. Thirrja e mbledhjes së 33-të të KK-së
108. Njoftim
109. Përfundojnë vizitat sistematike mjekësore për nxënësit e klasave të para të shkollave të Mitrovicës
110. Fillon asfaltimi i rrugëve në fshatin Gushavc të Mitrovicës
111. Lajmërim
112. Kuvendi i Komunës miraton Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025- 2027
113. Fillon asfaltimi i rrugës "Ali Zeneli" në Mitrovicë
114. Është mbajtur trajnimi dy ditor për dhënien e ndihmës së parë për stafin e Institucionit Parashkollor "Gëzimi ynë"
115. Orari i dëgjimeve buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitet 2025-2027
116. Ftesë Publike për Projektet Kulturore për OJQ-të për vitin 2024 (Thirrja e Parë)
117. U mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
118. Ftesë- për pjesëmarrje në dëgjimin e parë publik me qytetarë për planifikimin e Buxhetit për vitet 2025- 2027
119. Kryetari Hamza priti në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu
120. U mbajt mbledhja e radhës e KKS-së në Mitrovicë

121. Mbahet dëgjimi i parë publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2025
122. Ftesë - për pjesëmarrje në dëgjimin e dytë publik me përfaqësues të Kulturës, Rinisë, Sportit, Shoqërisë Civile dhe Komuniteteve për planifikimin e Buxhetit për vitet 2025 - 2027
123. Nënkryetari Tahiri monitoroi punimet në shkollën "Andon Zako Çajupi"
124. Mbahet dëgjimi i dytë buxhetor me përfaqësues të kulturës, rinisë, sportit dhe shoqërive civile
125. Ftesë - për pjesëmarrje në dëgjimin e tretë me Shëndetësinë për planifikimin e Buxhetit për vitet 2025 - 2027
126. Mbahet dëgjimi i tretë buxhetor me punëtorët e shëndetësisë
127. NJOFTIM - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
128. Ftesë - për pjesëmarrje në dëgjimin e katërt me gratë dhe vajzat për planifikimin e Buxhetit për vitet 2025 - 2027
129. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport - shpallje për aplikim
130. Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës
131. Seanca e 33-të
132. Mbahet dëgjimi i katërt publik me gra për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025
133. Nënkryetari Tahiri monitoron punimet në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica”
134. U mbajt mbledhja e radhës e Kuvendit Komunal të Mitrovicës
135. Konferenca: “Praktikat e Mira të Mësimdhënies: Përvojat dhe Perspektiva për të Ardhmen”
136. Përkujtohet veprimtari i shquar i çështjes kombëtare Sabit Veseli
137. Me moton “Lum Na”, në Mitrovicë filloi Green Festivali
138. Lokalizohet zjarri në Cernushë
139. Njoftim nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
140. Përkujtohet ish kryeministri Bajram Rexhepi në 7 vjetorin e vdekjes së tij
141. Nis festivali “Mitrovica International Jazz Days”
142. Përurohet kabineti i robotikës në shkollën teknike “Arkitekt Sinani”
143. Njoftim nga KQZ
144. Njoftim për Konsultim Publik- Projekt- Buxhetin e Komunës së Mitrovicës për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026-2027
145. Nënkryetari Tahiri viziton shkollën fillore “Migjeni” në fillimin e vitit të ri shkollor
146. Kryetari Hamza priti në takim Ambasadorin e Francës, Olivier Guérot
147. Kryetari Hamza dhe nënkryetari Tahiri dhurojnë gjak në QKMF-në e Mitrovicës
148. Njoftim
149. Në Mitrovicë mbahet “Karvani shëndetësor” për promovimin e edukimit shëndetësor
150. Njoftim për Konsultim Publik

151. Kuvendi Komunal mban konsultimin publik për projekt - buxhetin e komunës së Mitrovicës për vitin 2025
152. Njoftim për qytetarët përfitues të skemës së shtesave për fëmijë
153. Njoftim nga KQZ
154. U mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
155. F T E S Ë
156. T H Ë R R E T
157. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
158. U shënua 26 vjetori i Epopesë së Mazhiqit
159. Kryetari Hamza priti në takim ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen
160. FTESË PËR HOMAZHE
161. Ftesë për Aplikim "Grante për Bujqësi" Kuvendi Komunal i Mitrovicës miraton Buxhetin për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027
162. Njoftim nga sektori i tatimit në pronë
163. Filloi Java e Trashëgimisë Kulturore Evropiane në Muzeun e Mitrovicës
164. Komuna e Mitrovicës bënë ekzekutimin e subvencioneve për 599 qytetarë të Mitrovicës
165. Asfaltimi i rrugës "Lah Nimani" po shkon drejt fazës finale
166. FILLON VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL
167. KONSULTIM PUBLIK PËR DRAFT - STATUTIN
168. E BIBLIOTEKËS KOMUNALE TË MITROVICËS
169. Drejtorja për Shëndetësi
170. Përkujtohen dëshmorët Agim (Rrahim) Ramadani, Bislim Imeri dhe Mustafë Shyti
171. Mbahet marshi tradicional kundër kancerit të gjirit
172. Nënkryetari Tahiri viziton ndërmarrjen publike "Tregu" në Mitrovicë
173. Në Mitrovicë u mbajt konferenca "Të mbijetuarat e kancerit më të Fuqizuara dhe të Zëshme"
174. T H Ë R R E T
175. Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa
176. Seanca e 33
177. Konsultim Publik
178. Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2024 - 2027
179. Në Mitrovicë u shënua "Java e njeriut me shkop të bardhë"
180. Mbahet mbledhja e 33-të e Komitetit për Politikë dhe Financa
181. Vendoset gurthemeli i çerdhes së re në Mitrovicë

182. Mbledhja e rregullt të Kuvendit të Komunës- Seanca e 35-të

183. Njoftim për regjistrim për votim jashtë Kosovës
184. Në Mitrovicë u mbajt festivali i parë që promovon traditën dhe kulturën në një hapësirë
185. Komuna e Mitrovicës do të ndaj gjithsej 300 bursa për studentët e vitit akademik 2024/2025
186. U mbajt konferenca “Praktikat e mira të mësimdhënies- përvojat dhe perspektiva për të ardhmen”
187. Diskutim Publik
188. Për hartim të Draft- Rregullores për ndryshim- plotësim të Rregullores komunale Nr.01/2022 për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
189. Në lagjen "Iliridë" po punohet në rregullimin e rrugëve
190. Mbledhja e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa- Seanca e 34
191. Asfaltohen rrugicat në fshatin Këq të Madh
192. Ftesë për perurimin e QMF - së në Iliridë
193. ShFMU dhe AMF-ja në fshatin Zabërgj furnizohen me ujë të pijshëm
194. Nënkryetari Tahiri nënshkruan marrëveshje për renovimin e ndërtesave sociale në Mitrovicë
195. Përurohet objekti i ri i QMF-së në Iliridë të Mitrovicës
196. U mbajt mbledhja e 34-të e Komitetit për Politikë dhe Financa
197. Njoftim nga Drejtoria e Arsimit – Komuna e Mitrovicës
198. Nënkryetari Tahiri priti në takim Agnesa Veseli, nënkampione e Evropës në Muay Thai
199. T H Ë R R E T
200. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
201. Seanca e 36-të
202. Në Mitrovicë nis aksioni për largimin e deponive ilegale
203. Vazhdon asfaltimi i rrugëve në fshatin Broboniq
204. Njoftim nga Sektori i Tatimit në Pronë
205. Qyteti i Mitrovicës në prag të 28 Nëntorit zbukurohet me flamuj kombëtar dhe shtetëror
206. U mbajt mbledhja e radhës e Kuvendit Komunal të Mitrovicës
207. Agjenda për Festën e 28 Nëntorit
208. Përfaqësues komunal nderojnë dëshmorët për Festën e 28 Nëntorit
209. Miratohet Plani për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimet Sociale në Komunën e Mitrovicës
210. Ftesë
211. Kryetari Bedri Hamza thërret Komitetin për Menaxhimin e Emergjencave
212. Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca dhe Zjarrfikësit në Mitrovicë shpërndajnë ujë për qytetarët

213. Kryetari Hamza viziton rezervuarët e ujësjellësit dhe thekson rëndësinë e sigurisë dhe normalitetit
214. Përfaqësuesit komunal presin në takim drejtuesit e AME
215. Njoftim nga Drejtoria e Inspektionit për subjektet afariste dhe shitësit ambulant lidhur me lirimimin e hapësirave publike
216. Rihapet Qendra e Kulturës dhe Teatri i Qytetit pas renovimit të plotë
217. Drejtoresha Ibrahimë takon drejtuesit e Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuara
218. Në Mitrovicë shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara
219. U mbajt turne përkujtimor në kujtim të Erion Kajtazit
220. Tubimi i Dytë Publik i Kryetarit të Komunës për vitin 2024
221. U nënshkrua memorandum i bashkëpunimit mes të Komunës së Mitrovicës dhe Fondacioni për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus Kosova
222. Deklarimi i adresës zyrtare në e-Kosova
223. Kryetari Hamza viziton urën e re tek Liqeni Akumulues
224. Udhëheqësi Rama priti në takim KFOR-in LMT të Zvicrës
225. Superheronjtë në Mitrovicë
226. Thirrja e Mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa - Seanca e 35-të
227. Drejtoria e Bujqësisë ndau koshere bletësh për 81 përfitues
228. Thirrja e mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës- Seanca e 37-të
229. Mbahet takimi publik me qytetarë për vitin 2024
230. Ekspozita Etnologjike "Një Jetë në Gajtan"
231. Fillojnë netët festive me live koncerte në sheshin festiv "Mitrovica feston"
232. Në Mitrovicë përurohet "Ballkoni Panoramik"
233. E para e Arsimit në Mitrovicë, Drita Kadriu, ka falënderuar të gjithë mësimdhënësit e pensionuar të vitit 2024 për kontributin e tyre të çmuar në arsim.
234. U mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Politikë dhe Financa
235. Sonte në Sheshin Festiv në Mitrovicë, atmosfera vazhdon të jetë elektrizuese, me performanca nga artistë të ndryshëm dhe me një ambient të zjarrtë
236. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë pastron rrugët nga bora në disa fshatra të Mitrovicës
237. U mbajt mbledhja e fundit e Kuvendit Komunal të Mitrovicës për vitin 2024
238. Në 28 vjetorin e tij të rënies përkujtohet heroi Mehë Uka

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë (12) muajore **Janar- Dhjetor 2024**, Zyra për Komunikim me Publikun, ka pranuar gjithsej **76** kërkesa për qasje në dokumente publike, ku prej tyre **45** janë parashtruar në formë elektronike dhe **31** në formë fizike.

Të gjitha kërkesat e parashtruara për Komunën e Mitrovicës kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor.

Nr .	Parashtruesi i kërkesës	Mënyra e parashtrimit të kërkesës	Data e parashtrimit	Data e dërgimit tek drejtoria/ zyrtari përkatës për vlerësimin e qasjes	E vlerësuar si:	Data e kthimit të përgjigjes	Numri i dokumenteve të kërkuara
1.	Ensar Suma, gazetar në Portalin Online Vëzhguesi.com 01-034/01-000727/24	Elektronike	04.01.2024	04.01.2024	Qasje e Plotë	24.01.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, drekave dhe darkave për vitin 2023 të Kabinetit të Kryetarit dhe Drejtorëve komunal. Kërkesa është shqyrtuar nga Njësia përgjegjëse (Drejtoria për Buxhet dhe Financa) me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
2.	Rrezarta Prekazi, Studente 16-034/01-0001891/24	Fizike	10.01.2024	10.01.2024	Qasje e Plotë	12.01.2024	Pala ka kërkuar qasje në informata zyrtare që kanë të bëjnë me numrin për familjet me asistencë sociale dhe familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta për periudhën 2013-2023.
3.	Shemsi Jashari, drejtor ekzekutiv në “Demokracia Fillon Këtu – DFK” 01-034/01-0003853/24	Elektronike	16.01.2024	22.01.2024	Qasje e Plotë	29.01.2024	Pala ka kërkuar qasje në Informata që kanë të bëjnë me caktimin e Zyrtarit Përgjegjës për Konsultime Publike, planifikimi i konsultimeve publike në planin e komunës dhe planin për komunikim publik, si dhe pyetje tjera që kanë të bëjnë me transparencën komunale të punës së Ekzekutivit dhe Legjislativit të Komunës duke përfshirë proceset e mbajtjes së diskutimeve publike. Kërkesa në fjalë është shqyrtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.

4.	Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq 01-034/01- 0005163/24	Fizike	23.01.2024	24.01.2024	Qasje e Plotë	26.01.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet lidhur me përzgjedhjen e z. Selim Peci, anëtar i komisionit për mosvijimin e mësimit të nxënësve.
5.	Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq 01-034/01- 0009393/24	Fizike	07.02.2024	07.02.2024	Qasje e Pjesshme	21.02.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare dhe informata lidhur me lëndën e djalit të tij z.Granit Rushiti, i cili ka qenë kandidat në konkursin për ndarjen e bursave nga Komuna e Mitrovicës, si dhe qasje për kandidatët e tjerë. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
6.	Mustafë Shala, qytetar nga Mitrovica 01-034/01- 000968/24	Fizike	07.02.2024	07.02.2024	Qasje e Pjesshme	20.02.2024	Pala ka kërkuar qasje lidhur me dokumentet e kandidatëve që kanë aplikuar në konkursin për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në N.P.L “OMNI SPORT”. Kërkesa është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh duke u bazuar në Ligjin për qasje në dokumente publike.
7.	OJQ “EC Ma Ndryshe” 01-034/01- 0011435/24	Elektronike	13.02.2024	13.02.2024	Qasje e Plotë	20.02.2024	Pala ka kërkuar informata në Komunën e Mitrovicës së Jugut lidhur me numrin e aseteve hipotekare të regjistruara për periudhën Janar 2023- Dhjetor 2023 dhe cili aset është lënë më së shumti në hipotekë.
8.	Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq 01-034/01- 0016618/24	Fizike	05.03.2024	06.03.2024	Qasje e Plotë	11.03.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike lidhur me lëndë të QPS-së për shërbimet sociale.
9.	Rushit Rushiti, qytetar nga Leposaviq 04-030/01- 0019213/24	Fizike	15.03.2024	19.03.2024	Qasje e Plotë	21.03.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet publike lidhur me listën e cila është dërguar në DMZP-MPB, për zbritjen e koeficientit për z. Rushit Rushiti dhe disa zyrtarë tjerë të Qendrës për Punë Sociale.

10	OJQ “Mundësia” 01-034/01- 0022816/24	Elektronike	02.04.2024	02.04.2024	Qasje e Plotë	08.04.2024	Pala ka kërkuar qasje në Informata dhe përgjigje në disa pyetje që ndërlidhen me vlerësimin e transparencës komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2023.
11	Agon Prekazi 01-034/01- 0024864/24	Fizike	11.04.2024	15.04.2024	Qasje e Plotë	16.04.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me Vendimin për Anulimin e Konkursit për pozitën; Zyrtar për Teknologji Informative, me Nr. Reference RN00012864 dhe Nr. Protokolli 10-111/01-0085415/23, dt. 24.11.2023.
12	Nora Jusufi, Konsulente e Jashtme për “Finance Think” Institut për kërkime ekonomike dhe politika në Maqedoninë e Veriut 01-034/01- 0028846/24	Elektronike	26.04.2024	26.04.2024	Qasje e Plotë	16.05.2024	Pala ka kërkuar informata që kanë të bëjnë me programet apo masat për dhënien e granteve/subvencioneve në kulturë, rini dhe sport, mirëqenie sociale apo të tjera për vitet 2019-2023, masat në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Kërkesa e parashtruar është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditë sipas Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike.
13	Altina Kamberaj, hulumtuese 01-034/01- 0029306/24	Elektronike	29.04.2024	29.04.2024	Qasje e Pjesëshme	16.05.2024	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike që kanë të bëjnë me Shpenzimet Publike në arsimin publik të realizuara më specifikisht në dy nivelet e arsimit, atë primar dhe sekondar në nivelin lokal (Komunën e Mitrovicës së Jugut), mundësisht për vitet 2008-2023. Kërkesa në fjalë është trajtuar me afat shtesë prej 15 ditësh sipas Ligjit.

14	Rudina Hasimja, hulumtuese në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile 01-034/01- 0029312/24	Elektronike	29.04.2024	29.04.2024	Qasje e Plotë	16.05.2024	Pala ka kërkuar qasje në informata që kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve për vitin 2023 nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.
15	Gazeta Online Veriu.info 01-034/01- 0029292/24	Elektronike	29.04.2024	29.04.2024	Qasje e Pjesshme	03.05.2024	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike për kontratën për dhënie në shfrytëzim të tokës për N.T.P “Tropik” për ndërtimin e parkingut nëntokësor përball Komunës, që është dhënë në shfrytëzim në vitin 2018, duke përfshirë të gjitha shkresat e lëndës për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, përfshirë edhe Planin e Operatorit Ekonomik për këtë parking.
16	Lavim Hyseni, qytetar nga Mitrovica 01-034/01- 0029710/24	Fizike	29.04.2024 Zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike ka pranuar kërkesën 02.05.2024	02.05.2024	Qasje e Plotë	08.05.2024	Pala ka kërkuar informata lidhur me konkursin për pozitën Inspektor i Tregut dhe atë për kualifikimin e kandidatëve të cilët kanë kaluar verifikimin paraprak.
17	Bletë Rashiti, Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion- “QIKA” 01-034/01- 0029698/24	Elektronike	30.04.2024	30.04.2024	Qasje e Plotë	03.05.2024	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente zyrtare lidhur me subvencione, transfere dhe dëgjimet publike të ndara sipas gjinisë.
18	Lavdim Hyseni, qytetar nga Mitrovica 01-034/01- 0029884/24	Fizike	02.05.2024 Zyrtarja përgjegjëse për qasje në dokumente publike ka	03.05.2024	Qasje e Plotë	08.05.2024	Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me konkursin për pozitën Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit dhe atë përvojën e punës së kandidatëve të cilët e kanë kaluar verifikimin paraprak.

